VENDIM
Nr.59, datë 29.12.2004

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 28 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të ERE–s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2004, pasi shqyrtoi draftin e paraqitur nga Departamenti i Tarifave dhe i Çmimeve për Metodologjinë e Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

Miratimin e Metodologjisë së Llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema